

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik pranë Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike si më poshtë:

A. 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik me karakter administrativ në pozicionin “Laborant” në Departamentin e Inxhinierisë Kimike, duhet të plotësojë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të ketë diplomë të studimeve universitare në sistemin 3+2 apo diplomë të integruar të nivelit të dytë në Kimi/degët e saj.
2. Të ketë eksperiencë pune në laborator.
3. Të ketë njohuri të gjuhëve të huaja, preferohet gjuha angleze.
4. Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe pune në grup.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimi (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj e noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **09.10.2024** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.